



Datë: 08.05.2025
Numër Protokolli: 3132/2025

A.nr.440/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.440/2025, të datës 10.03.2025, të parashtruar nga ankuesja H.M, kundër organit të punësimit-Autoritetit të Aviacionit Civil, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa Anr.440/2025, të datës 10.03.2025, të parashtruar nga ankuesja H.M.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, H.M. (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 10.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërtetimit me numër protokolli 2025/BNJ/62 të datës 18.02.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil për korrigjimin e Vërtetimit me numër protokolli 2025/BNJ/52 të datës 13.02.2025 për përvojën e punës dhe Dëshmisë me numër protokolli 2025/BNJ/63 të datës 18.02.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil për korrigjimin e Dëshmisë me numër protokolli 2025/BNJ/52 të datës 13.02.2025 për masën disiplinore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 19.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil, ndërsa, kjo e fundit më datë 08.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1535/2025 të datës 10.03.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vërtetimin me numër protokolli 2025/BNJ/52 i datës 13.02.2025; Dëshmi për masë disiplinore me numër protokolli 2025/BNJ/53 e datës 13.02.2025; Vërtetimin me numër protokolli 2025/BNJ/62 të datës 18.02.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil për korrigjimin e Vërtetimit me numër protokolli 2025/BNJ/52 të datës 13.02.2025 për përvojën e punës; Dëshmisë me numër protokolli 2025/BNJ/63 të datës 18.02.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil për korrigjimin e Dëshmisë me numër protokolli 2025/BNJ/52 të datës 13.02.2025 për masën disiplinore; Emailin e datës

25.02.2025 nga S.S për ankuesen; Emailin e datës 25.02.2025 nga ankuesja për B.D; Emailin e datës 25.02.2025 nga B.D për ankuesen; Emailin e datës 24.02.2025 nga ankuesja për S.S; Emailin e datës 21.02.2025 nga S.S. për ankuesen; Emailin e datës 18.02.2025 nga ankuesja për S.S; Emailin e datës 18.02.2025 nga S.S për ankuesen; Emailin e datës 14.02.2025 nga ankuesja për S.S; Emailin e datës 13.02.2025 nga S.S për ankuesen; Emailin e datës 13.02.2025 nga ankuesja për S.S; Konkurs i jashtëm për pozitën Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore i datës 14.12.2016, 24.02.2017, 23.03.2017; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 25.05.2017; Njoftimin për përzgjedhje i datës 25.05.2017; Vendimin me Nr. 70/2017 i datës 08.06.2017 i KPMSHCK-së; Akt Emërimit i datës 28.06.2017; Akt Emërimit i datës 08.06.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore datës 16.03.2017; Vendimin A.nr.312/2022 i KPMSHCK-së; Vendimin me Nr. ref.30/2020 i datës 18.05.2020; Konkursin për Drejtor të Përgjithshëm i datës 27.01.2025 i shpallur nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës; Konkursin për Drejtor Ekzekutiv i darës 27.01.2025 i shpallur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; Vërtetimin e datës 03.08.2020; Vërtetimin për marrëdhënien pune i darës 20.11.2021, 20.02.2023, 27.06.2023; Pasqyre nga SIMBNJ për ankuesen; Vendimin V.Nr.10.2024 i datës 04.04.2024; Kartelën e nëpunësit civil për ankuesen; Kopjen e ID-së së ankuses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.03.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 08.04.2025; Dëshmi nga SIMBNJ e datës 23.03.2017; Pasqyrën nga SIMBNJ për pozitat e Departamenteve në AAC; Kërkesë për ndryshimin e aktit të emërimit e datës 06.04.2022 nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e AAC për Drejtorin e Përgjithshëm të AAC; Emailin e datës 21.12.2023 nga A.R për S.S; Emailin e datës 21.12.2023 nga S.S për A.R; Kërkesë për verifikim e datës 20.12.2023 nga Policia e Kosovës; Emailin e datës 07.02.2023, 06.02.2023 nga S.S për B.E; Emailin e datës 07.02.2023 nga B.E për S.S; Emailin e datës 06.02.2023 nga S.S për ankuesen; Emailin e datës 30.01.2023 nga ankuesja për S.S; Vendimin me Nr. ref.00/2023 i datës 07.02.2023 pa nënshkrim dhe pa protokoll; Listën e pagave prill 2023; Raportin e Auditimit nga MFPT prill 2023; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 19.07.2019 për Sh.S-K; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 19.07.2019 për S.K; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 19.07.2019 për S.S; Vendimin e datës 22.04.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuses.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e palejuar, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 08.06.2018, mbanë pozitën e punës *Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore*, në Autoritetin e Aviacionit Civil. Tutje sipas shkresave të lëndë, rezulton se ankuesja përmes emailit të datës 13.02.2025, ka kërkuar nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që të lëshoj për ankuesen dëshmi lidhur për përvojën e punës dhe masë disiplinore, ndërsa, ne raport më kërkesën e ankuses Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore më datë 13.02.025, ka lëshuar Vërtetimin e përvojës së punës me numër protokolli 2025/BNJ/52, po ashtu, me të njëjtën datë ka lëshuar edhe dëshminë për masë disiplinore me numër protokolli 2-25/BNJ/53, e sipas të cilave dokumente pozitës së ankuese i është referuar Drejtoreshë e Departamenti për Administratë dhe Burime Njerëzore.

Me tej, Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Autoritetit të Aviacionit Civil, më datë 18.02.2025 ka lëshuar Vërtetimin me numër protokolli 2025/BNJ/62 për korrigjimin e vërtetimit të datës 13.02.2025 me nr. Protokolli 2025/BNJ/52 të përvojës së punës, si dhe Dëshminë me numër protokolli 2025/BNJ/63 për korrigjimin e dëshmisë për masë disiplinore të datës 13.02.2025 me Nr.prot, 2025/BNJ/53, ku sipas këtyre dokumenteve korrigjimi është bërë tek pozita e ankuses nga Drejtoreshë e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore është korrigjuar në pozitën Drejtoreshë e Departamentit për Administratë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërtetimit me numër protokolli 2025/BNJ/62 të datës 18.02.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil për korrigjimin e Vërtetimit me numër protokolli 2025/BNJ/52 të datës 13.02.2025 për përvojën e punës dhe Dëshmisë me numër protokolli 2025/BNJ/63 të datës 18.02.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil për korrigjimin e Dëshmisë me numër protokolli 2025/BNJ/52 të datës 13.02.2025 për masën disiplinore, pretendon se këto dokumentet janë nxjerrë në kundërshtim me aktin emërimit mbi bazë të të cilit ushtroj pozitën dhe mbi bazë të të gjitha akteve të tjera të brendshme. Kërkon që ankesa të aprovohet, të anulohen aktet e kontestuar dhe të obligohet Autoriteti i Aviacionit Civil që pozitën Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore ta vendos në sistemin SIMBNJ.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se *“Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”*, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim*, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se me aktet-dokumentet e kontestuar ankueses nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e tij të punës, rrejdhimisht aktet e atakuar më ankesë janë dëshmi që vërtetojnë faktet lidhur me përvojën e punës dhe masave disiplinore, andaj, në këtë rast ankueses i mungon legjitimiteti i palës dhe si rrjedhojë Ankesa A.nr.440/2025 është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.

Referuar emërimit të pozitës së ankueses në aktet e kontestuar, e për çka ankuesja pretendon se i është falsifikuar pozita nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të AAC-së, Kolegji nga analizimi i provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesja ka në fuqi Aktin e fundit të Emërimit të datës 08.06.2018, sipas të cilit akt ankuesja është emëruar në pozitën e punës me titull Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore, ndërsa, sipas përgjigjes në ankesë AAC-ja ka të miratuar rregulloren për organizma të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, e plotësuar dhe e ndryshuar në vitin 2025, mirëpo, sipas shkresave të lëndës nuk vërtetohet se AAC-ja ka të përfunduar procesin e riorganizimit, andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, Kolegji erdhi në përfundimin se Njësia e Burimeve Njerëzore të AAC-së është e obliguar që ankueses ti lëshoj dëshmi përkatës lidhur me përvojën e punës dhe gjendjen e masave disiplinore duke u bazuar në aktin e emërimit në fuqi të datës 08.06.2018 dhe të bëjë korrigjimet e nevojshme në SIMBNJ.

Kështu që, për sa me sipër, Kolegji duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.440/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses H.M.;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.